



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1139 prot.

Tiranë, më 07. 08. 2024

V E N D I M

Nr. 221, datë 07. 08. 2024

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*¹, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën² nr. 102, datë 16.05.2024, në emër të shtetasit K. A. i përfaqësuar nga Av. A. P.³, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të *“përkatësisë në një grup të veçantë”*⁴ dhe *“aftësisë së kufizuar”*, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Lezhë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,⁵

K O N S T A T O I:

I. Pretendimet sipas subjektit ankues.

Në ankesën e paraqitur pranë KMD-së, ndër të tjera, nga ana e përfaqësuesit ligjor të K. A. është parashtruar ndër të tjera se: *“Shtetasi K. A., prej 24 vitesh është diagnostikuar me “Skizofreni kronike refraktare” i trajtuar në kushte ambulatorie, nga mjeku psikiatër Gj. P. nga viti 2011, deri më 26 gusht 2020.*

Më, 26 gusht 2020, forcat e Komisarariatit të Policisë Mirditë, kanë arrestuar K. A., si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Kundërshtim i punonjësve të policisë së rendit publik” dhe “Shkatërrim prone”, vepra këto të parashikuara në nenin 236/2 e 150 të Kodit Penal.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Plotësuar përmes e-mailit datë 29.05.2024

³ Përfaqëson ankuesin me Akt-Përfaqësimi nr. 9736 prot., datë 29.05.2024, lëshuar prej tij në prani të përfaqësuesve të IEVP Lezhë.

⁴ Shtetasi K. A. bën pjesë në grupin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, ndaj të cilit duhet të zbatohet masa mjekësore e mjekimit të detyruar në një Institucion Mjekësor përkatës, në pavionin e personave me çrregullime psikike, përcaktuar nga Vendimi Nr. 2, datë 29.07.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, dhe që është i akomoduar në ambientet e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lezhë, referuar Urdhrit nr. 280 prot., datë 08.10.2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.

⁵ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr. 2, datë 29.07.2021, ka vendosur:

- *Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë.*
- *Pushimin e çështjes penale nr. 490 akti të vitit 2020, për veprat penale të parashikuara nga nenet 151 e 236/2 të Kodit Penal.*
- *Caktimin e masës mjekësore “mjekim i detyruar në një institucion mjekësorë” për shtetasin K. P. A., i datëlindjes 30.05....., lindur në K..... dhe banues në K....., Bashkia Mirditë.*
- *Kopje e këtij vendimi gjyqësor ti dërgohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë.*
- *Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Shkodër, afati i ankimit fillon ditën e nesërme të komunikimit të këtij vendimi gjyqësor.*

Vendimi i mësipërm ka marrë formë të prerë më datë 21.09.2021, pasi nuk u ankimua. Më 08.10.2021, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, ka urdhëruar:

- *Ekzekutimin e vendimit penal nr. 2, datë 29.07.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, të dhënë ndaj të gjykuarit K. P. A.*
- *Për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Tiranë.*
- *Me ekzekutimin e këtij urdhri të njihet K. P. A.*
- *Për ekzekutimin e këtij urdhri të njoftohemi zyrtarisht.*

Urdhri i ekzekutimit datë 08.10.2021, dhe titulli ekzekutiv i është dërguar për ekzekutim Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve Tiranë, të cilët fillimisht e kanë dërguar K. A. në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Krujë dhe më vonë e kanë transferuar në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lezhë, ku dhe ndodhet aktualisht.

Gjykata e Rrethit Lezhë, në rastin në fjalë, ka vendosur vetëm mjekim të detyruar pranë një institucioni mjekësor dhe jo burgim në sistemin e burgjeve, për rrjedhojë, kufizimi i lirisë së K. A. sikurse rezulton në urdhrin e ekzekutimit të prokurorisë është në kundërshtim me vendimin e Gjykatës dhe statusin e tij si person me çrregullime të shëndetit mendor. Mbajtja e tij, fillimisht në ambientet e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Krujë dhe më vonë në ambientet e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Lezhë, jo vetëm nuk i ka garantuar një trajtim kurues, sipas urdhërimeve të gjykatës, por regjimi izolues i sistemit të burgjeve, ka ndikuar në mos shërimin e tij.

K. A. është diskriminuar pasi nuk i ofrohet i njëjti shërbim mjekësor në raport me personat e tjerë me çrregullime të shëndetit mendor që kurohen në institucione shëndetësore publike si dhe i është kufizuar liria dhe të drejtat e sanksionuara me Kushtetutë, tej masës që përcakton vendimi gjyqësor. Gjithashtu, fakti që ai nuk merr shërbimin mjekësor në përputhje me protokollin e miratuar të çrregullimeve të skizofrenisë, për rrjedhojë, vihet në pozita diskriminuese.

Qëndrimi për një kohë shumë të gjatë në institucionet e sistemit të burgjeve në kushtet e mësipërme, cenon seriozisht të drejtën për të pasur një trajtim mjekësor të specializuar dhe e diskriminon atë në raport me personat me të njëjtat çrregullime të shëndetit mendor, që kurohen në spitale të specializuara jashtë sistemit të burgjeve. Një trajtim i tillë konsiderohet çnjerëzor

dhe degradues, sepse rezulton i paramenduar dhe është realizuar për një periudhë kohore të gjatë, si dhe ka ndikuar në rehabilitimin e shëndetit mendor.

Gjatë kohës së qëndrimit në ambientet e I EVP Krujë dhe më vonë në ambientet e I EVP Lezhë, me masë mjekësore “mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”, K. A., është mbajtur në kushte burgimi, në një dhomë tej kapacitetit të lejuar.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, po gjykohet kryesisht kërkesa për rishqyrtim të masës mjekësore për K. A. Gjatë periudhës korrik 2022 deri në mars 2024, ai është transportuar nga I EVP Lezhë, për në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, gjithsej 27 herë. Në të gjitha rastet është transportuar në një furgon të policisë së burgut, së bashku me persona të tjerë të paraburgosur, të cilët ishin në pritje të gjykit.

Automjeti tip furgon i policisë së burgut është i projektuar për transportin e të paraburgosurve dhe jo të pacienteve me çrregullime të shëndetit mendor. Furgoni i policisë së burgjeve që ka shërbyer për transportin e tij, nuk është një ambulancë apo ndonjë mjet tjetër spitalor.

Duke pasur parasysh gjendjen shëndetësore të K. A., kohëzgjatjen e udhëtimit dhe ndikimin e dëmshëm në gjendjen e tij shëndetësore, transporti i tij në një furgon burgu standard ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në vuajtjen e tij dhe për këtë arsye përbën trajtim çnjerëzor e degradues. Keqtrajtimi ka patur një nivel ashpërsie, për rrjedhojë hynë brenda fushës së neni 25 të Kushtetutës.

K. A., gjatë shoqërimit nga ambientet e I EVP Lezhë, për në Gjykatë, në të gjitha rastet, është sjellë nga toga e shoqërimit policor, me duar të lidhura me pranga, si të gjithë të paraburgosurit e tjerë, që janë transportuar me të. K. A. nuk ka ndonjë procedim penal në ngarkim të tij, as nuk është duke u gjykuar për kryerjen e ndonjë veprë penale dhe as nuk po vuan ndonjë dënim penal.

Ai nuk ka paraqitur ndonjë rrezik për tu arratisur, nga vendi ku mbahet në ambientet e I EVP Lezhë, ose për të shkaktuar vetëlëndim apo lëndim të të tjerëve. Përdorimi i prangave është në disproporcion me statusin e tij, si dhe nevojat e sigurisë.

Në të 27 rastet që K. A. është paraqitur para gjykatës i lidhur me pranga, këtë trajtim diskriminues e degradues e kam ngritur disa herë para Gjykatës, këtë paligjshmëri, por gjyqtari vazhonte gjykimin, sikur nuk kishte ndodhur asgjë. Duke pasur parasysh gjendjen shëndetësore të K. A., mungesën e ndonjë arsyeje për tu frikësuar se ai përfaqësonte një rrezik sigurie dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme nga punonjësit e armatosur të policisë së burgjeve, vlerësoj se përdorimi i kufizimeve në ato kushte përbën trajtim çnjerëzor e degradues sipas neni 25 të Kushtetutës. Fenomene të tilla nuk mund të ndodhin as në një vend të degjeneruar të botës së tretë e jo më në një vend si Shqipëria që kërkon të aderojë për tu bërë pjesë e Bashkimit Europian”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së saj pranë Komisionerit subjekti ankues, ka kërkuar të konstatohet diskriminimi i drejtpërdrejtë për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë dhe aftësisë së kufizuar, kundrejt tij nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lezhë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, germa “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke garantuar në mënyrë të shprehur mbrojtje në lidhje me shkaqet e pretenduara nga subjekti ankues. Në nenin 1, të LMD përcaktohet: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet *ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Në Kreun IV, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Në nenin 20 *“Të mirat dhe shërbimet”*, të LMD përcaktohet: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:*

a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

a) mundësi për të hyrë në një vend ku publiku lejohet të hyjë ose për të përdorur një vend, i cili lejohet për t’u përdorur nga publiku;

b) mundësi për të marrë ose për të përfutur nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin;...”

- Nga shqyrtimi paraprak i ankesës nr. 102, datë 16.05.2024, rezultoi se ajo kishte mangësi të anës formale të saj. Sakaq, fillimisht përmes e-mail-it datë 28.05.2024, i kërkoi përfaqësuesit

të ankuesit, të vërë në dispozicion të Komisionerit një dokument ligjor/akt përfaqësimi për Av. A. P.

Në përgjigje sa më lart, përfaqësuesi i subjektit ankues me anë të e-mail-it datë 29.05.2024, vuri në dispozicion një kopje të Akt-Përfaqësimit nr. 9736 prot., datë 29.05.2024, lëshuar nga ana e K. A., në prani të përfaqësuesve të IEVP Lezhë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Në vijim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës nr. 681/1 prot., datë 03.06.2024, i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Ministrisë së Drejtësisë (MD), Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB) dhe Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, (IEVP) Lezhë duke kërkuar informacion sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje përsa më lart, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përmes shkresës⁶ nr. 2598/1 prot., datë 21.06.2024, informoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke theksuar ndër të tjera se: *“...Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Drejtësisë vijnë angazhimin e tyre të përbashkët për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, sipas parashikimeve të kuadrit rregullator vendas dhe standardeve ndërkombëtare në këtë fushë.*

Në këtë kuadër, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka marrë angazhimin për të përshtatur objektin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor me Shtretër në Shkodër në Institucion Mjekësor të Posaçëm për pacientet gra me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore “mjekim i detyruar” (me një kapacitet rreth 35 shtretër) dhe transferimin e tyre nga Qendra Spitalore e Burgjeve në institucionin e ri në Shkodër, brenda këtij viti. Për këtë qëllim është ngritur një grup ndërsektorial pune për vlerësimin e nevojës së ndërhyrjeve në infrastrukturë dhe mobilitet të godinës së Shërbimit të Shëndetit Mendor me Shtretër në Shkodër për tu shndërruar në Institucion Mjekësor të Posaçëm për gratë, për zhvillimin e kuadrit rregullator për mënyrën e krijimit dhe funksionimit të këtij institucioni, si dhe burimet njerëzore të nevojshme për ofrimin e shërbimit terapeutik dhe të sigurtë. Ky grup pune do të planifikojë gjithashtu transferimin e shërbimit spitalor të shëndetit mendor për pacientët civilë në një pavijon psikiatrik në Spitalin Rajonal Shkodër, duke siguruar integritetin e plotë të shërbimit të shëndetit mendor në kujdesin e përgjithshëm shëndetësor.

Gjithashtu po punojmë, nëpërmjet ekspertëve të këtij grupi pune, për identifikimin e një strukture akomodimi të përshtatshme për një trajtim të denjë të individëve, burra, me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, mundësisht në afërsi të Tiranës,

⁶ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 681/2 prot., datë 26.06.2024.

me synimin për të pasur akses më të madh në profesionistë të ndryshëm që duhet të rekrutohen për ofrimin e shërbimeve multidisiplinare në këtë institucion.

Hartimi i studimit të fizibilitetit për vendndodhjen e re, me synim rritjen e nivelit të maturimit të këtij projekti për mbështetjen e financimit ndërkombëtar është një nga hapat që ky grup pune do të ndërmarrë në vijim.

Ndërkohë janë krijuar edhe grupe të tjera pune ndërsektoriale për:

- Zhvillimin e protokollit për përdorimin e barnave me injeksion për menaxhimin e sigurt dhe efektiv të sjelljes së dhunshme tek personat me çrregullime të shëndetit mendor;
- Zhvillimin e formatit të planit individual të trajtimit për personat me çrregullime të shëndetit mendor në shërbimet e shëndetit mendor me shtretër;
- Rishikimin e aktiviteteve të planit të përbashkët të veprimit, aneks i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Drejtësisë, nën dritën e rekomandimeve të CPT-së dhe të të gjitha zhvillimeve më të fundit në këtë fushë. Ky grup pune, i bashkëkryesuar nga të dy zëvendësministrat e Shëndetësisë dhe të Drejtësisë, do të angazhohet edhe në monitorimin e zbatimit të planit të përbashkët të veprimit të rishikuar.

Në kuadër të projektit të HF III “Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut për personat e dënuar në Shqipëri”, të Këshillit të Europës (KiE), kemi planifikuar zhvillimin e metodologjisë dhe instrumenteve për kategorizimin e rrezikut të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore “mjekim i detyruar” dhe trajnimin e stafëve zbatues.

Hartimi i një kurrikule trajnimi në fushën e psikiatrisë ligjore dhe zbatimi i trajnimeve në vendin e punës, si dhe hartimi i sistemit të referimit të pacientëve që dalin nga institucioni dhe do të trajtohen në nivel komunitar, do të jenë gjithashtu pjesë e ndërhyrjeve të ardhshme në kuadër të bashkëpunimit me KiE”.

Në përgjigje përsa më lart, Ministria e Drejtësisë përmes shkresës⁷ nr. K-105/1 prot., datë 26.06.2024, informoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke theksuar ndër të tjera se: “...Shtetasit me çrregullime të shëndetit mendor janë akomoduar pranë Institucionit të Kujdesit Shëndetësor Lezhë konform Urdhrit të Ekzekutimit të Prokurorit dhe marrëveshjes së bashkëpunimit “Për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore”, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 6111 prot., datë 23. 11.2021 dhe pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr, 4787 prot., datë 23.11.2021 (bashkëlidhur), në përmbajtje të së cilës parashikohet se:

Deri në krijimin e Institucionit Mjekësor të Posaçëm nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, Institucioni i Kujdesit Shëndetësor Lezhë, përkatësisht godinat 4 dhe 5 të tij, do të jenë institucioni tranzitor në të cilin do të akomodohen shtetasit me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore.

Aktualisht, me urdhër nr. 68, datë 30.04.2024 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj”, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lezhë ka pësuar ndryshime në

⁷ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 681/2 prot., datë 26.06.2024.

strukturë duke u bërë Institucion Mjekësor i Posaçëm. Informacion më i detajuar ju është përcjellë me shkresë nr. 5051/1 prot., datë 11.06.2024 të Institucionit Mjekësor të Posaçëm IEVP Lezhë.

Gjithashtu, vlerësojmë të sjellim në vëmendjen tuaj se është institucioni i Prokurorisë, i cili në Urdhrin e tij të Ekzekutimit përcakton institucionin përgjegjës për zbatimin e vendimeve gjyqësore me masë mjekësore. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është institucion ekzekutues në zbatim të disponimeve në urdhrin e ekzekutimit të Prokurorit.

Ministria e Drejtësisë mbetet e gatshme për çdo informacion shtesë që do të konsideroni të nevojshëm”.

2. Komisioneri me anë të e-mail-it datë 28.06.2024, i përcolli subjektit ankues parashtrimet e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në përgjigje të këtij e-maili, subjekti ankues nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë parashtrim.

3. Përmes e-mail-eve datë 11-12.07.2024, Institucioni Mjekësor i Posaçëm IEVP Lezhë⁸, vuri në dispozicion të Komisionerit shkresën nr. 5051/1 prot., datë 11.06.2024, lidhur me ankesën e K. A., duke theksuar ndër të tjera se:

“...Në zbatim të urdhërit Nr. 68, datë 30.04.2024 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj”, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lezhë pëson ndryshime në strukturë duke u bërë Institucion Mjekësor i Posaçëm (IEVP Lezhë), gjë kjo që sjell transferimin e të paraburgosurve në një IEVP tjetër dhe trajtimin vetëm të shtetasve me masë mjekësore.

Në zbatim të këtij urdhëri, me qëllim trajtimin e shtetasve me masë mjekësore në organikën e IMP Lezhë është shtuar ndjeshëm numri i punonjësve në sektorin e mjekësisë duke arritur në 53 punonjës dhe është ulur numri i punonjësve të policisë nga 201 në 85.

Kapaciteti në IMP Lezhë aktualisht është 300 shtretër por janë bërë përshtatje në dhoma duke akomoduar 446 shtetas me masë mjekësore.

Shtetasi K. A. i biri i P... dhe D..., i datëlindjes 01.06....., lindur dhe banues në Mirditë është arrestuar më datë 26.08.2020, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Kundërshtim i punonjësve të policisë dhe rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i K. Penal dhe me vendimin Nr. 1327, datë 29.08.2020 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur:

1. Vleftësimin e ligjshëm të arrestit të vendosur nga Policia Gjyqësore ndaj të arrestuarit K. A..

2. Caktimin e masës së sigurimit “Shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik”.

Me vendimin Nr. 2, datë 29.07.2021 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur:

1. Pushimin e çështjes penale Nr. 490 akti, viti 2020 për veprat penale të parashikuar nga nenet 151 e 236/2 të K. Penal.

2. Caktimin e masës mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor” për shtetasin K. P. A., lindur dhe banues në Mirditë.

⁸ Në vijim do ti referohemi me akronimin IMP Lezhë

Shtetasi K. A. ka ardhur në IEVP Lezhë më datë 27.11.2021 nga IEVP Krujë dhe që nga ardhja e tij në këtë institucion ai ndodhet i akomoduar në Seksionin e shtetasve me masë mjekësore “Shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik” dhe “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”, përkatësisht Godinat Nr. 4 dhe 5. Shtetasi K. P. A. aktualisht ndodhet i akomoduar në godinën Nr. 4 , kati 3, dhoma Nr. 6.

Sa i përket trajtimit shëndetësor: K. P. A., i datëlindjes 01.06.1971, i akomoduar në IMP (IEVP) Lezhë, në ambientet e personave me çrregullime të shëndetit mendor, me diagnozë: Çrregullim skizo-afektiv...

Pacienti trajtohet në bazë të konsultave mjekësore të realizuara nga Mjekët psikiatër të Institucionit, si dhe konsultat e bëra në Spitalin Rajonal Lezhë nga mjekët specialist të fushës.

Në lidhje me sjelljen dhe qëndrimin e shtetasit me “Mjekim të Detyruar” K. P. A.. Gjatë periudhës së qëndrimit në institucion ky shtetas ka shfaqur sjellje dhe qëndrim konform rregullores pa tendenca të kundërshtimit apo të mospranimi ndaj urdhrave dhe udhëzimeve të personelit. Nga monitorimet e kryera është vënë re që ka ndërtuar marrëdhënie korrekte e bashkëpunuese me shtetasit e tjerë me të cilët e lidhin veprimtaritë e përditshme, si dhe aktivitetet në grup me karakter social edukativ të zhvilluara nga sektori social me mbështetje dhe të shërbimeve të tjera institucionale.

Ka qenë pjesë e këshillimeve individuale periodike (suporti psikologjik), gjatë të cilave ka qenë përgjithësisht i gatshëm të bashkëpunojë për arritjen e objektivave të planit individual të trajtimit”.

Gjithashtu, IMP Lezhë theksoi se shoqërimi në gjykatë i të dënuarve me masë mjekësore nga Institucioni Mjekësor i Posaçëm Lezhë bëhet me autoambulancë, ku janë prezent punonjësi i policisë, ndihmës mjeku dhe kujdestari. Shtetasve me masë mjekësore nuk ju vendosen pranga dhe për çdo problematikë veprohet dhe ndërhyhet vetëm me urdhër të mjekut ose stafit mjekësor që është prezent, duke zbatuar parashikimet e ligjit 44/2012.

Bashkëngjitur përgjigjes së sipërcituar Institucioni Mjekësor i Posaçëm IEVP Lezhë, vuri në dispozicion:

- Urdhrin Nr. 8927/1, datë 27.09.2018, të Ministrit të Drejtësisë, “Për klasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, ku është vendosur kalimi në konservim (mbyllje e përkohshëm IEVP Krujë, për shkak të kushteve të papërshtatshme për trajtimin e shtetasve me masë mjekësore. Bazuar në plan masash nr. 1240 prot., datë 18.11.2021 “Për transferimin e shtetasve me masë Mjekësor nga IEVP Krujë në IEVP Lezhë”;
- Urdhrin Nr. 68, datë 30.4.2024, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj”;
- Urdhrin Nr. 18, datë 12.01.2024, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e Formatit të Planit Individual të Trajtimit të Personave me Çrregullime të Shëndetit Mendor në Shërbimet e Specializuara me Shtretër”;
- Vendimin Përfundimtar të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë të ankuesit dhe të shtetasve të tjerë në kushte të njëjta me të.

Nga informacioni dhe dokumentacioni i administruar gjatë procedurave hetimore rezulton se, është fakt i provuar dhe i pranuar nga palët në proces që:

- Shtetasi K. A., referuar diagnozës së vendosur nga mjekët specialistë neuropsikiatër, është person me çrregullime të shëndetit mendor, prej më shumë se 20 (njëzet) vitesh me: Dg. Skizofrenia kronike refrektare⁹.

Më datë 26.08.2020, ankuesi është arrestuar nga ana e Komisariatit të Policisë Mirditë, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Kundërshtim i punonjësve të policisë së rendit publik*” dhe “*Shkatërrim prone*”, të parashikuara në nenin 236/2 e 150 të Kodit Penal.

Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr. 2, datë 29.07.2021, ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë;
- Pushimin e çështjes penale nr. 490 akti të vitit 2020, për veprat penale të parashikuara nga nenet 151 e 236/2 të Kodit Penal.
- Caktimin e masës mjekësore “*mjekim i detyruar në një institucion mjekësorë*” për shtetasin K. P. A., i datëlindjes 30.05....., lindur në K..... dhe banues në K....., Bashkia Mirditë;
- Kopje e këtij vendimi gjyqësor ti dërgohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë.

Vendimi i mësipërm ka marrë formë të prerë më datë 21.09.2021, pasi nuk është ankimuar nga ana e palës ankuese. Sakaq, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, me Urdhrrin nr. 280 prot., datë 08.10.2021 ka urdhëruar:

- Ekzekutimin e vendimit penal nr. 2, datë 29.07.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, të dhënë ndaj të gjykuarit K. P. A.;
- Për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Tiranë;
- Me ekzekutimin e këtij urdhri të njihet K. P. A.;

Në zbatim të Urdhrit të Ekzekutimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, K. A. është vendosur fillimisht në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Krujë dhe më datë 27.11.2021, është transferuar nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lezhë, ku dhe ndodhet aktualisht.

⁹ Referuar, shkresës nr. 535/1 prot., datë 31.05.2023 të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor “Shenja Mari” Mirditë.

Referuar urdhërit nr. 8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë *“Për klasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”*, IEVP Lezhë klasifikojë *“burg i sigurisë të zakonshme”*, me një seksion paraburgimi dhe një seksion i veçantë për trajtimin e shtetasve me masë mjekësore *“mjekim të detyruar”*.

Aktualisht, nga informacioni i administruar, me urdhër nr. 68, datë 30.04.2024 të Kryeministrit *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj”*, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lezhë ka pësuar ndryshime në strukturë duke u bërë Institucion Mjekësor i Posaçëm IEVP Lezhë.

Referuar Strukturës dhe Organikës së re të Institucionit Mjekësor të Posaçëm IEVP Lezhë, ajo ka pësuar ndryshimet si më poshtë vijon:

Mbështetur në Raportin datë 24.11.2023, drejtuar Qeverisë Shqiptare, të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimeve ose Ndëshkimeve Çnjerëzore ose Degraduese (KPT) dhe Rekomandimit datë 17.06.2022 të Avokatit të Popullit, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lezhë, përbëhet nga 241 punonjës, prej të cilëve 32 punonjës ishin staf civil dhe 209 ishin punonjës me uniformë të sektorit të shërbimit të sigurisë të institucionit. Konkretisht raportin e KPT-së, konstatohet se: *“...Në një letër të datës 12 prill 2023, autoritetet shqiptare nënkuptojnë se që nga muaji tetor 2022, ekipi i dy psikiatërve me turne 24-orëshe ishte shtuar me dy psikiatër shtesë. Megjithatë, në momentin e vizitës, dy psikiatër shtesë nuk ishin angazhuar ende. Për rrjedhojë, në objektin e përkohshëm nuk kishte ende prani të përditshme të mjekut psikiatër¹⁰... Përveç dy psikiatërve, institucioni i përkohshëm punësonte edhe 3 psikologë (njëri prej tyre psikolog klinik i trajnuar i cili e ndante kohën e tij ndërmjet institucionit të përkohshëm dhe seksionit të paraburgimit), 5 punonjës socialë, 1 mjek i lartë (drejtues i njësisë mjekësore), 1 stomatolog, 1 mjek i përgjithshëm, 1 farmacist, 10 kujdestare dhe 10 pastruese. Gjithashtu, kishte 16 infermiere, përfshirë 1 kryeinfermiere, asnjëra prej të cilëve nuk ishte e specializuar në çështjet e shëndetit mendor. Institucioni kërkonte të rekrutonte 1 kardiolog dhe 1 teknik laborator¹¹”*.

Aktualisht, struktura dhe organika e miratuar me urdhrin nr. 68, datë 30.04.2024 të Kryeministrit *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj”*, Institucioni Mjekësor i Posaçëm IEVP Lezhë përbëhet nga 180 punonjës, prej të cilëve 95 punonjës janë staf civil dhe 85 janë punonjës me uniformë të sektorit të shërbimit të sigurisë të institucionit. Sa i përket punonjësve që bëjnë pjesë në stafin mjekësor, ata ishin të organizuar në Sektorin e Masave Mjekësore IEVP Lezhë, i cili përbëhej nga 53 punonjës. Konkretisht:

- 1 Shef Shërbimi (Mjek i Përgjithshëm/Mjek Specialist);
- 3 Mjek të Përgjithshëm/Mjek Specialist;

¹⁰ Paragrafi 138 i Raportit të KPT-së.

¹¹ Paragrafi 140 i Raportit të KPT-së.

- 6 Mjek Psikiatër;
- 1 Mjek Kardiolog;
- 1 Mjek Laborant Klinik Biokimik;
- 1 Mjek Stomatolog;
- 1 Kryeinfermier;
- 1 Farmacist;
- 17 Infermier;
- 1 Infermier/Laborant;
- 10 Kujdestar (Për pacientë me masë mjekësore);
- 10 Sanitar (Për pacientë me masë mjekësore).

Ministria e Drejtësisë përmes shkresës nr. K-105/2 prot., datë 26.06.2024, ka theksuar se shtetasit me çrregullime të shëndetit mendor janë akomoduar pranë Institucionit të Kujdesit Shëndetësor Lezhë konform Urdhrit të Ekzekutimit të Prokurorit dhe marrëveshjes së bashkëpunimit *“Për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore”*, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 6111 prot., datë 23. 11.2021 dhe pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr, 4787 prot., datë 23.11.2021, në përmbajtje të së cilës parashikohet se: *“Deri në krijimin e Institucionit Mjekësor të Posaçëm nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, Institucioni i Kujdesit Shëndetësor Lezhë, përkatësisht godinat 4 dhe 5 të tij, do të jenë institucioni tranzitor në të cilin do të akomodohen shtetasit me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore”*.

Konkretisht në përmbajtjen e marrëveshjes së bashkëpunimit përcaktohet se:

Ministria e Drejtësisë merr përsipër:

- a. Vendosjen në dispozicion të pajisjeve që disponon, me qëllim përshtatjen dhe pajisjen me aparaturat e nevojshme të dy godinave pranë Institucionit të Kujdesit Shëndetësor, Lezhë duke siguruar mjedis fizik të përshtatshëm për ofrimin e kujdesit terapeutik, human dhe të sigurtë për personat me çrregullime të shëndetit mendor, me masë mjekësore, sipas përcaktimeve të nenit 28 të ligjit nr 44/2012 *“Për shëndetin mendor”*.
- b. Ofrimin e masave të sigurisë për ruajtjen e këtij institucioni.
- c. Vazhdimin dhe përmirësimin e kujdesit të sigurtë nëpërmjet rishikimit të protokolleve dhe procedurave për funksionimin e këtij institucioni transitor dhe trajnimeve të stafit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale merr përsipër:

- a) Ofrimin e shërbimit të specializuar psikiatrik mbështetës për stafin e institucionit të Kujdesit Shëndetësor Lezhë nëpërmjet angazhimit të mjekëve sipas nevojave.
- b) Sigurimin e diagnostikimit dhe trajtimit të specializuar.
- c) Ofrimin e ekzaminimeve laboratorike, depistime epidemiologjike dhe asistencë për diagnozë nëpërmjet ISHP-së.
- d) Planifikimin e ngritjes dhe funksionimit të Institucionit Mjekësor të posaçëm, si strukturë e posaçme për ofrimin e një kujdesi terapeutik.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në datat 27 dhe 28 nëntor 2021 është bërë transferimi i pacientëve psikiatrikë mjeko-ligjorë meshkuj nga Institucioni i Posaçëm për të Burgosurit Mendor Zaharia në Krujë në ambientet e sapohapura në IEVP Lezhë¹². Në të njëjtën kohë është bërë edhe transferimi i ankuesit, K. A. në ambientet e IEVP Lezhë.

Ligji nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i ndryshuar, ka përcaktuar dhe ka evidentuar faktin se, trajtimi shëndetësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor, pavarësisht veprës penale që kanë kryer dhe për të cilët gjykata kompetente ka vendosur masën “*mjekim i detyruar*” apo “*shtrim i detyruar*”, duhet të kryhet në një Institucion të Posaçëm Mjekësor (pjesë e sistemit shëndetësor të integruar) dhe jo në institucionet e sistemit penitenciar.

Konkretisht, në nenin 28 të këtij ligji, përcaktohet se: “1. *Institucionet mjekësore të posaçme janë institucione, që shërbejnë për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale, për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor të të paraburgosurve apo të të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave, për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas nenit 239 të Kodit të Procedurës Penale. 2. Trajtimi i personave në institucionet mjekësore të posaçme është i njëjtë me trajtimin e pacientëve të tjerë me çrregullime të shëndetit mendor. Institucionet mjekësore të posaçme, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, janë pjesë e sistemit shëndetësor të integruar. Mënyrat dhe rregullat e ngritjes dhe funksionimit të këtyre institucioneve mjekësore të posaçme dhe masat e sigurisë për ruajtjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.*

Ky përcaktim ligjor, tregon qartë prioritetin që legjislativi i ka dhënë mbrojtjes së shëndetit të këtyre personave, para natyrës së veprës penale që kanë kryer, si dhe ka përcaktuar institucionet mjekësore të posaçme, ku duhet të kryhet trajtimi mjekësor i tyre.

Mbështetur në Raportin datë 24.11.2023, drejtuar Qeverisë Shqiptare, të KPT-së, referohet ndër të tjera se: “...114. Kjo ishte hera e parë që KPT-ja vizitoi objektin e përkohshëm që kur ai ishte funksional. Në vitin 2018¹³ dhe 2021¹⁴, delegacionet e KPT-së kishin bërë vizita në ambientet e objektit të ardhshëm të përkohshëm dhe e kishin konsideruar atë të papërshtatshëm për qëllimin e akomodimit të pacientëve të mjekësisë ligjore psikiatrike, për shkak të paraqitjes së saj si burg dhe mungesës së hapësirës për seancat terapeutike¹⁵.

115. *Ambienti i përkohshëm ndodhej brenda burgut të Lezhës, i cili përbëhej më tej nga një seksion për të paraburgosurit dhe një njësi për të burgosurit paraplegjikë. Objekti i përkohshëm ishte vendosur në ndërtesat 4 dhe 5: dy godina ngjitur, të ndërlidhura, trekatëshe, me planimetri*

¹² Paragrafi 105 i Raportit të KPT-së.

¹³ KPT/Inf (2019) 28, paragrafi 103

¹⁴ KPT/Inf (2022) 08, paragrafët 24-25

¹⁵ KPT/Inf (2019) 28, paragrafi 103 dhe KPT/Inf (2022) 08, paragrafi 24

të ngjashme. Kati i parë dhe i dytë i të dy ndërtesave përmbanin gjithsej 24 qeli të stilit të konviktit, për pesë deri në shtatë pacientë secila, me ambiente sanitare të integruara për pothuajse të gjithë, si dhe një banjë të përbashkët për kat me katër dushe. Të dy katet përdhes kishin qeli për deri në 10 pacientë dhe një dhomë të përbashkët. Ambientet mjekësore, të përbëra nga dy dhoma dhe një dhomë për këshillim psiko-social ndodheshin në katin e parë të godinës 5, ndërsa në katin përdhes të godinës 4 kishte një qeli izolimi.

116. Me një kapacitet zyrtar prej 280 pacientësh, objekti i përkohshëm ishte i mbipopulluar që në fillim. Në momentin e vizitës, kishte 404 pacientë meshkuj, si rezultat në qeli të caktuara më pak se 3.2 m2 hapësirë jetese për person^{16 17}.

117. Nuk kishte rregulla specifike të zbatueshme për ambientin e përkohshëm. Me sa duket ishte hartuar një rregullore e brendshme që pasqyronte kushtet specifike në objektin e përkohshëm dhe ishte në proces miratimi nga Ministria e Drejtësisë. Deri në miratimin e tij, zbatohen dispozitat e Ligjit dhe Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve e vitit 2022, megjithëse këto nuk janë zbatuar gjithmonë germe për germë, shpesh në dobi të pacientëve (për shembull, lejimi i aksesit të pakufizuar për telefon dhe rregullimet më bujare të vizitave).

Gjithashtu, Rregullorja e Përgjithshme të Burgjeve parashikon se: “Trajtimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor kryhet sipas legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve dhe legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor”¹⁸. Prandaj, siç është theksuar në mënyrë të përsëritur nga drejtoria e burgut Lezhë, trajtimi i pacientëve të akomoduar në godinat 4 dhe 5 rregullohet nga Ligji i Shëndetit Mendor të vitit 2012. Kjo përfshinte përdorimin e mjeteve të kufizimit, të cilat, në përputhje me nenin 87 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve¹⁹ zbatoheshin ndaj autorëve të dhunës, nëse ishte e përshtatshme, në vend të masës disiplinore të përfshirë në nenin 64 të Ligjit.”

Sikurse rezultoi nga përgjigja referuar shkresës nr. 5051/1 prot., datë 11.06.2024, të IMP Lezhë, kapaciteti i saj aktualisht është 300 shtretër por janë bërë përshtatje në dhoma duke akomoduar 446 shtetas me masë mjekësore. Pra konstatohet se, në këtë institucion ka një mbipopullim mbi kapacitetin fizik të përcaktuar.

Sikurse Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka konstatuar ndër vite gjatë shqyrtimit të çështjeve të ngjashme²⁰, kjo kategori personash ka vuajtur dhe jetuar në kushte jo dinjitoze dhe në kundërshtim me aktet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Për këtë kategori personash, është shprehur edhe GJEDNJ në çështjen “*Strazimiri kundër Shqipërisë*”²¹, për të cilën konstatoi në veçanti që kishte pasur një dështim të gjatë nga autoritetet

¹⁶ Për shembull, qelia 2 në ndërtesën 4 kishte një sipërfaqe prej rreth 19 m2 (pa sipërfaqe tualeti) dhe përmbante gjashtë shtretër

¹⁷ Shih gjithashtu paragrafin 175

¹⁸ Neni 21 (2) i Rregullores

¹⁹ Neni 87 i Rregullave të Përgjithshme të Burgut lejon mos dhënien e masave disiplinore të renditura në nenin 64 të Ligjit-së, në rast se “rëndësia e tyre (nuk) kuptohet nga i burgosuri dhe për aq sa i shërbejnë qëllimit të tyre rehabilitues”

²⁰ Vendimi nr. 44, datë 07.02.2018, nr. 255, datë 19.12.2018 dhe nr. 45, datë 28.03.2019.

shqiptare për të ngritur një institucion të posaçëm mjekësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor, të cilët ishin privuar nga liria në rastet e trajtimit të detyrueshëm mjekësor të urdhëruar nga gjykata vendase.

Pavarësisht masave të marra për përmirësimin e kushteve dhe kthimit të IEVP Lezhë në Institucion Mjekësor të Posaçëm, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, referuar shkresës nr. 2598/1 prot., datë 21.06.2024, theksoi se është angazhuar, për identifikimin e një strukture akomodimi të përshtatshme për një trajtim të denjë të individëve, burra, me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore “*mjekim i detyruar*”, mundësisht në afërsi të Tiranës, me synimin për të pasur akses më të madh në profesionistë të ndryshëm që duhet të rekrutohen për ofrimin e shërbimeve multidisiplinare në këtë institucion.

Nga shqyrtimi i çështjeve të trajtuara më parë, rezulton se MSHMS dhe MD kanë marrë angazhimin e tyre për ngritjen dhe funksionimin e Institucionit Mjekësor të Posaçëm që prej vitit 2018, por sipas tyre, ky u arrit të realizohej në vitin 2024.

Pra, referuar parashtrimeve të paraqitura më sipër nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nuk rezulton që Institucioni Mjekësor i Posaçëm Lezhë, është një strukturë akomodimi e përshtatshme apo përfundimtare për një trajtim të denjë të individëve, burra, me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore “*mjekim i detyruar*”.

Në përfundim, u konstatua që:

- vijon të ketë një mbipopullim të Institucionit Mjekësor të Posaçëm Lezhë të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore “*mjekim i detyruar*”;
- pavarësisht ngritjes dhe miratimit të Institucionit Mjekësor të Posaçëm Lezhë, për trajtimin e individëve, burra, me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore “*mjekim i detyruar*”, ai vijon të jetë brenda strukturës/ambienteve së një Institucioni të Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe jo mirëfilltë një institucioni mjekësor publik për kurimin e këtyre shtetasve;
- pavarësisht se Ligji nr. 44/2012 “*Për Shëndetin Mendor*”, i ndryshuar, përcakton se, trajtimi shëndetësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor, duhet të kryhet në një Institucion të Posaçëm Mjekësor (pjesë e sistemit shëndetësor të integruar) dhe jo në institucionet e sistemit penitenciar, Institucioni Mjekësor i Posaçëm Lezhë mbetet sërish brenda strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe jo të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

²¹ Ky rast është trajtuar edhe nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe kishte të bënte me ndalimin e një njeriu, i cili ishte përjashtuar nga përgjegjësia penale për shkak të çrregullimeve të shëndetit mendor, në një burg në vend të një institucioni mjekësor. Parashtruesi ankohej në veçanti se kushtet e ndalimit të tij, përfshirë sigurimin e kujdesit mjekësor, ishin joadekuate. Ai po ashtu konsideronte se ishte vendosur në një burg edhe pse gjykatat kishin urdhëruar mbylljen e tij në një institucion mjekësor, se nuk i ishte dhënë mundësia që ligjshmëria e ndalimit të tij të vendosej shpejt nga një gjykatë dhe se ligji i brendshëm nuk i kishte ofruar një të drejtë të zbatueshme për kompensim.

- nuk u konstatua që nga ana e MSHMS-së apo MD-së të ishte miratuar një rregullore e posaçme për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore “mjekim i detyruar”.

Referuar parashtrimeve të subjektit ankues sa i përket shoqërimit të tij për në gjykatë me automjetin tip furgon të policisë së burgut dhe me duar të lidhura me pranga, duke u trajtuar si të gjithë të burgosurit e tjerë, ato mbeten deklarative dhe Komisioneri nuk arriti të sigurojë prova të mjaftueshme nga palët për të provuar pretendimet e tij. Evidentohet se nga ana e Institucionit Mjekësor të Posaçëm Lezhë është mohuar një fakt i tillë duke deklaruar se shoqërimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, bëhet me autoambulancë, të palidhur dhe të shoqëruar nga stafi mjekësor. Në këtë kuadër, duke qenë se pretendimet e palëve mbeten deklarative, Komisioneri nuk arriti të administroj prova për ti vërtetuar ato.

Në analizë të sa mësipër, është fakt i njohur dhe i pranuar nga të gjitha palët e përfshira në këtë proces administrativ, se shtetasit (përfshirë edhe subjektin ankues) me vendim gjykate, me masë mjekësore “Mjekim i detyruar” dhe “Shtrim i përkohshëm” janë akomoduar në Institucionit Mjekësor të Posaçëm Lezhë, duke filluar nga muaji nëntor i vitit 2021 dhe vetëm në muajin prill 2024, është ngritur institucioni i veçantë mjekësor për ta. Pavarësisht ngritjes së tij, nuk rezultoi që ai të jetë një strukturë akomoduese e mirëfilltë dhe brenda kushteve për trajtimin e shtetasve me masë mjekësore “Mjekim i detyruar” dhe “Shtrim i përkohshëm”.

Pra, sipas provave të administruara, pavarësisht ngritjes së Institucionit Mjekësor të Posaçëm Lezhë dhe përshtatjes së ambienteve të tij për për trajtimin e shtetasve me masë mjekësore “Mjekim i detyruar” dhe “Shtrim i përkohshëm”, ata sërish janë të akomoduar brenda territorit të një institucioni penitenciar, duke mos i dhënë një zgjidhje të përshtatshme dhe përfundimtare kësaj problematike të mbartur prej vitesh. Sakaq, ankuesi dhe personat e ndodhur në kushte të njëjta me të, janë vendosur në pozita të pabarabarta me personat e tjerë me çrregullime të shëndetit mendor, në mungesë të ofrimit të shërbimit të njëjtë mjekësor si atyre që kurohen në institucione shëndetësore publike, duke kufizuar lirinë dhe të drejtat e sanksionuara me Kushtetutë, tej masës që përkon me vendimin gjyqësor të formës së prerë.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2²² të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

²²Neni 2: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Bazuar në dokumentacionin që disponon nga hetimi, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues mbart shkakun e pretenduar, atë të përkatësisë në një grup të veçantë; pasi hyn tek ato subjekte me aftësi të kufizuar me çrregullime të shëndetit mendor, për të cilët gjykata ka faktuar kryerjen e një krimi, pra ka cilësuar rrezikshëmërinë shoqërore të tyre, gjithsesi duke i përjashtuar nga përgjegjësia penale.

“Përkatësia në një grup të veçantë” është shkak për të cilin ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Shtetasi K. A. është i diagnostifikuar me diagnozën: Skizofrenia kronike refraktare²³. Pas kryerjes së veprës penale *“Kundërshtim i punonjësve të policisë së rendit publik”* dhe *“Shkatërrim prone”*, në vitin 2020, ankuesi është arrestuar nga ana e Komisarariatit të Policisë Mirditë dhe me Vendimin nr. 2, datë 29.07.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ndaj tij është vendosur: *“Pushimin e çështjes penale nr. 490 akti të vitit 2020, për veprat penale të parashikuara nga nenet 151 e 236/2 të Kodit Penal. Caktimin e masës mjekësore “mjekim i detyruar në një institucion mjekësorë” për shtetasin K. A....”*.

Pra, në kontekst të shpjegimit sa më sipër, ky shtetas bën pjesë në grupin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, ndaj të cilit duhet të zbatohet masa mjekësore e mjekimit të detyruar në një institucion shëndetësor, përcaktuar nga vendimi gjyqësor i formës së prerë, por është akomoduar fillimisht në ambientet e IEVP Lezhë e më pas në IMP Lezhë. Pra, ai “de facto” trajtohet si një person “i dënuar”, kur në fakt duhet të trajtohej si “pacient me çrregullime të shëndetit mendor” në një institucion psikiatrik, në zbatim të vendimit gjyqësor sipërcituar.

²³ Referuar, shkresës nr. 535/1 prot., datë 31.05.2023 të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor “Shenja Mari” Mirditë.

Komisioneri vlerëson se shtetasi K. A., referuar shkresës nr. 535/1 prot., datë 31.05.2023 të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor “Shenjeta Mari” Mirditë, prej më shumë se 20 vitesh është diagnostikuar me diagnozën: Skizofrenia kronike refrektare, bart shkakun e aftësisë së kufizuar.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë me shkaqet e mbrojtura.

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Lezhë, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të pretenduar nga ankuesi, sipas parashikimeve të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”²⁴, të ndryshuar, dhe trajtimit të pafavorshëm të tij.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përligje e arsyeshme për trajtimin ndryshe të evidentuar.

Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: “*Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik*”.

Neni 18, i saj shpreh se “*1.Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit*”. Neni 25, përcakton se: “*Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti*”.

Po sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore²⁵ është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj dhe në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Neni 14, Ndalimi i diskriminimit, përcakton se : “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër*”. Protokollin 12 i saj ndalon diskriminimin në lidhje me “*gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji*” dhe kështu

²⁴Në interpretim të nenin 1, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, “*...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

²⁵Në vijim do ti referohemi me shkurtesën KEDNJ. Ajo është ratifikuar nga RSH me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996.

është më i madh në fushëveprimin e tij sesa Neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Neni i 3 i KEDNJ-së, parashikon se: *“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, as dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues”*.

Në këtë kontekst, GJEDNJ-ja²⁶ ka renditur shpesh e në mënyrë të përsëritur nenin 3²⁷, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ndalimin e torturës dhe trajtimin çnjerëzor, së bashku me nenin 2, të drejtën për jetën, si një nga të drejtat më themelore që mbrohen nga Konventa, qëllimi thelbësor i së cilës është që të mbrojnë dinjitetin e një individi e integritetin e tij fizik. Termat e pakushtëzuar të nenit 3 nënkuptojnë se asnjëherë, në bazë të Konventës ose të së drejtës ndërkombëtare, nuk do të ketë justifikim për aktet që çenojnë këtë nen. GJEDNJ-ja shprehet se edhe në rrethanat më të vështira, si për shembull, në luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, Konventa ndalon në terma absolutë torturën dhe trajtimin apo dënimin çnjerëzor apo poshtërues. Duhet theksuar fakti se ndalimi absolut zbatohet njësoj në çështjen e trajtimit të personave të ndaluar me motive mjekësore dhe/ose që i nënshtrohen trajtimit mjekësor. Në këtë kontekst, i përket autoriteteve mjekësore që të vendosin, në bazë të rregullave të njohura të shkencës së mjekësisë për metodat terapeutike që duhen përdorur, për të ruajtur shëndetin fizik dhe mendor të pacientëve. Pacientë të tillë mbeten nën mbrojtjen e nenit 3, të Konventës, kushtet e të cilit nuk lejojnë devijime.

Autoritetet përgjegjëse të një shteti kanë detyrimin që të mbrojnë shëndetin e personave që mbahen në ambientet e sistemit të burgjeve. Mungesa e trajtimit të duhur mjekësor mund të çojë në një trajtim që bie ndesh me nenin 3, të KEDNJ-së.

Trajtimi i papërshtatshëm shëndetësor me pasoja të dëmshme për shëndetin e pacientëve me çrregullime të shëndetit mendor, ka qenë objekt i analizës dhe vendimmarrjes së GJEDNJ, në çështjen *“Groni kundër Shqipërisë”*, ku Gjykata konstatoi cënim të nenit 3 të Konventës, duke argumentuar se rreziku i çrregullimeve të shëndetit mendor është shoqëruar me mungesën e trajtimit të përshtatshëm mjekësor dhe kohëzgjatjen e kohës së burgimit (megjithëse shtetasi Groni kishte cilësinë e një shtetasi të dënuar dhe jo me masë mjekësore, që vuante nga një çrregullim të shëndetit mendor). Sipas GJEDNJ-së, mungesa e trajtimit të duhur mjekësor ka çuar në trajtimin degradues të tij, të parashikuar në kuptimin e nenit 3 të KEDNJ-së.

Gjithashtu, në vitin 2020, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në vendimin e saj në çështjen *Strazimiri kundër Shqipërisë*²⁸, konstatoi shkelje të nenit 3 të Konventës për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Gjykata konstatoi se z. Strazimiri, subjekt i një vendimi gjyqësor i urdhëruar për trajtim të detyrueshëm spitalor, iu nënshtrova një trajtimi çnjerëzor dhe degradues për shkak të efektit kumulativ të kushteve të këqija materiale në Spitalin e Burgut të Tiranës, ku ishte i

²⁶Shkurtesë për Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

²⁷Neni 3 i KEDNJ-së *“Ndalimi i torturës”*, përcakton se: *“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese”*.

²⁸ Aplikimi 34602/16, 21 janar 2020

burgosur që nga viti 2011, si dhe të pamjaftueshmërisë psikiatrike dhe trajtimit terapeutik të dhënë.

GJEDNJ-ja është shprehur se kur autoritetet shtetërore burgosin një person me aftësi të kufizuara, ata duhet të tregojnë një kujdes të veçantë, në mënyrë që kushtet e vuajtjes së dënimit me heqje lirie t'u përgjigjen nevojave specifike të aftësisë së tij të kufizuar. (*Pricek. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 33394/96, par. 25; *Farbtuhs k. Letonisë*, nr. 4672/02, par. 56, 2 dhjetor 2004)

GJEDNJ-ja ka dalë në përfundimin edhe në disa raste të tjera në lidhje me vendosjen në një institucion të mbyllur të një personi të paaftë ligjërisht nën kujdestari, nga sjellja e të cilit ishte e qartë se ata nuk kanë dhënë pëlqimin për vendosjen e tyre, se ata duhet të konsiderohen si “të privuar nga liria” sipas kuptimit të nenit 5, paragrafi 1, të KEDNJ, pavarësisht miratimit të kujdestarit (shih, për shembull, vendimin e Dhomës së Madhe në çështjen Stanev kundër Bullgarisë, nr. 36760/06, § 132, 17 janar 2012, dhe Cervenka kundër Republikës Çeke, nr. 62507/12, §§ 103-104, 13 tetor 2016)

Ndalimi i torturës, trajtimit ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor apo degradues për personat me aftësi të kufizuara, është në thelb të nenit 15 të KDDPAK²⁹-së.

Shqipëria e ratifikoi KDDPAK në Dhjetor të vitit 2012 dhe është bërë Palë në të që prej 11 Shkurtit 2013. Në bazë të Kushtetutës, kjo Konventë është pjesë e sistemit ligjor shqiptar (nenin 122/1), renditet pas Kushtetutës në hierarkinë e akteve normative (neni 116/1) dhe ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të (neni 122/2).

KDDPAK, në nenin 5 të saj, ndalon diskriminimin ndaj kujtdo për shkak të aftësisë së kufizuar, duke marrë në konsideratë faktin që diskriminimi pengon njerëzit të gëzojnë të drejtat e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët. Konventa parashikon edhe hapat që duhen ndërmarrë për të siguruar përshtatjen e arsyeshme, ndaluar diskriminimin de facto dhe forma diskriminuese që mund të shfaqen në të ardhmen, si dhe për të promovuar të drejtën e personave me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta me të tjerët. Ndalimi i diskriminimit, përveç se një e drejtë e veçantë, është edhe një nga parimet bazë të Konventës që udhëheq interpretimin dhe zbatimin e të drejtave të tjera të mbrojtura në të. Dispozitat e tjera shpjegojnë çfarë përbën diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar në fushat e përkatëse, si dhe masat, përfshirë edhe ato pozitive, për të arritur barazinë në praktikë.

KDDPAK, në nenin 9 të saj³⁰, e konsideron aksesueshmërinë në kushte të barabarta me të tjerët si kusht thelbësor që personat me aftësi të kufizuara të mund të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të

²⁹Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

³⁰1. Me qëllim që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar, ashtu si gjithë të tjerë të kenë akses në ambientet fizike, ndaj transportit, informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë edhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në facilitete apo shërbime të tjera të disponueshme apo të ofruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa, të cilat do të

marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës. Legjislacioni shqiptar e përkufizon aksesueshmërinë si mënjanim i pengesave të të gjitha llojeve, duke përfshirë: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar; c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.

Në nenin 14 të KDPAK bëhet dallimi ndërmjet a) kufizimit të lirisë së personave me aftësi të kufizuara kur akuzohen, ndiqen penalisht ose dënohen për kryerjen e një veprë penale³¹ dhe b) rastit kur u kufizohet liria për shkak të aftësisë së kufizuar dhe rrezikshmërisë (shtrimi i pavullnetshëm në një institucion shëndetësor).

Të gjithë personat me aftësi të kufizuara kanë nevojë për kujdes shëndetësor njësoj si të tjerët dhe si rrjedhim të kenë akses të njëjtë në shërbimet e zakonshme shëndetësore. Neni 25 i KDPAK përforcon të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të siguruar nivelin më të madh të shërbimeve shëndetësore pa asnjë diskriminim.

Neni 55/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka sanksionuar se: *“Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti”*. Prandaj, ndaj këtyre shtetasve, (të ndodhur në kushtet të njëjta apo të ngjashme me shtetasin K. A.) duhet të zbatohen protokollet përkatëse, të cilat duhet të jenë të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

përfshijnë evidentimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave ndaj aksesit do të zbatohen ndër të tjera: (a) Në ndërtesa, rrugë, transport dhe facilite të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, qendrat shëndetësore apo ambientet e punës; (b) Informacion, komunikim dhe shërbime të tjera, përfshirë shërbimet elektronike dhe ato të urgjencës.

2. Gjithashtu, shtetet Palë duhet të marrin masat e duhura për: (a) Të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar zbatimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale në lidhje me aksesin ndaj objekteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruar për publikun; (b) Tu siguruar që subjektet private të cilat ofrojnë objekte dhe shërbime, të cilat janë të hapura apo të siguruar për publikun të marrin parasysh të gjitha aspektet e aksesit për personat me aftësi të kufizuar; (c) Të ofruar trajnim për aktorët e interesit lidhur me problemet që kanë të bëjnë me aksesin për personat me aftësi të kufizuar; (d) Tu siguruar që ndërtesat dhe objektet e tjera publike të përmbajnë shenja në gjuhën Braille dhe në forma lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme; (e) Të siguruar forma asistence direkte dhe të ndërmjetme, duke përfshirë guida, lexues dhe interpretë profesionistë të gjuhës së shenjave, për të mundësuar aksesin në ndërtesa dhe objekte të tjera publike; (f) Të inkurajuar forma të tjera të përshtatshme të asistencës dhe mbështetjes për personat me aftësi të kufizuar për tu siguruar që ata të kenë akses në informacion; (g) Të nxitur aksesin e personave me aftësi të kufizuara ndaj e informacioneve të reja dhe sistemeve të teknologjive e reja të komunikimit, duke përfshirë dhe internetin; (h) Të promovuar projektimin, zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e teknologjive dhe sistemeve të aksesueshme të informacionit dhe komunikimit në një fazë të hershme, në mënyrë që këto teknologji dhe sisteme të bëhen të aksesueshme me një kosto minimale.

³¹Rasti i shtetasit K. A.

Ndër ligjet specifike për personat me aftësi të kufizuara, Ligji nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor” parashikon shprehimisht ndalimin e torturës, trajtimit ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor apo degradues të personave me çrregullime të shëndetit mendor në nenin 8 të tij.

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen më të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime të shëndetit mendor. Rehabilitimi që, sipas ligjit, përfshin përpjekjet për rikthimin e aftësive të funksionimit social të një personi me çrregullime të shëndetit mendor, është një nga parimet e këtij ligji i cili synohet të arrihet në të gjitha nivelet e shërbimeve të ofruara.

Sipas nenit 5³², të ligjit nr.44/2012 “Për shëndetin mendor”, personat me çrregullime mendore, duke përfshirë edhe personat e papërgjegjshëm penalisht trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor. Atyre duhet t’u ofrohet kujdes në një mjedis sa më pak shtrëngues, nga ekupe multidisciplinare që i përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore, psikologjike, sociale dhe të rehabilitimit. Përkundrejt këtij parashikimi, pacientët me masë mjekësore “mjekim i detyruar” dhe me masë sigurimi “shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik” janë vendosur dhe mbahen në mënyrë të paligjshme në institucionet penitenciare dhe ndaj tyre aplikohet një regjim i mirëfilltë sigurie burgu. Edhe pas miratimit dhe riorganizimit të IEVP Lezhë në Institucion të Posaçëm Mjekësor, pacientët me masë mjekësore “mjekim i detyruar” dhe me masë sigurimi “shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik”, janë akomoduar në këto ambiente të cilat nuk përmbushin standardet e institucioneve shëndetësore ku ata duhet të vendosen.

Në nenin 6³³ të po këtij ligji, personat me çrregullime të shëndetit mendor gëzojnë të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme kushtetuese, të drejtën të marrin shërbim shëndetësor të arritshëm dhe efikas, në kushte të barabarta si të gjithë pacientët e tjerë, të drejtën për trajtim, bazuar në respekt të individualitetit dhe dinjitetit të tyre.

³²1. Parimet e përgjithshme të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor janë:

- a) Trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime të shëndetit mendor, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor.
- b) Ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor në një mjedis sa më pak shtrëngues, kryesisht në nivel komunitar, për të shmangur në maksimum zhvendosjet nga mjedisi familjar e për të lehtësuar integrimin dhe rehabilitimin social.
- c) Krijimi i lehtësive për këta persona dhe familjet e tyre me qëllim përfshirjen e tyre në jetën shoqërore.
- ç) Ofrimi i kujdesit për personat me çrregullime të shëndetit mendor nga ekupe multidisciplinare që i përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore, psikologjike, sociale dhe të rehabilitimit.
- d) Ushtrimi i të drejtave të personave me çrregullime të shëndetit mendor, në përputhje me aktet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Zbatimi i parimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, garantohen nga autoritetet shtetërore, përgjegjëse të shërbimit të shëndetit mendor.

³³1. Personat me çrregullime të shëndetit mendor gëzojnë:

- a) të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm kushtetues;
- b) të drejtën të marrin shërbim shëndetësor të arritshëm dhe efikas në kushte të barabarta si të gjithë pacientët e tjerë;
- c) të drejtën për trajtim dhe mbrojtje, bazuar në respekt të individualitetit dhe dinjitetit të tyre;

Neni 8³⁴, i ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, ka përcaktuar se: “1. Personave me çrregullime të shëndetit mendor u sigurohet mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, në bazë të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, në këtë fushë. 2. Asnjë person me çrregullime të shëndetit mendor nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit ose trajtimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues”.

Trajtimi aktual i kësaj kategorie shtetasish bie ndesh dhe me vetë qëllimin e ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, i cili ka në thelb të tij mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin problemeve që lidhen më të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime të shëndetit mendor.

Referuar dokumentit “Mbi Rregullat Europiane të Burgut”, miratuar nga Këshilli i Europës³⁵ në pikën 100/1 të tij përcakton se: “Personat që konstatohen me probleme të shëndetit mendor nuk duhet të mbahen në burg, por duhet të dëgohen sa më shpejt që të jetë e mundur në vende të përshtatshme për këtë kategori personash”.

Në referencë të Raportit të Komitetit European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues³⁶, lidhur me trajtimin e personave me çrregullime mendore në sistemin e burgjeve, personat me masë mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion” konsiderohen “pacientë” dhe jo “të burgosur”. Ndër të tjera, aty theksohet se: “...KPT-ja ngre rishtaz çështjen e pranisë në Spitalin e Burgjeve të pacientëve psikiatrikë të deklaruar jo të përgjegjshëm dhe që i janë nënshtroar një mase mjekësore “shtrim i detyruar në një spital psikiatrik”. Këta pacientë ende mbahen në Spitalin e Burgut dhe jo në një institucion të specializuar mjekësor ose në institucion psikiatrik, siç është parashikuar në legjislacionin përkatës shqiptar. Deri më sot, autoritetet shqiptare kanë dështuar për të gjetur zgjidhje të kënaqshme për këtë problem, dhe ka pasur shumë pavendosmëri për të ngritur një institucion të veçantë në Durrës ose në Krujë”.

Në paragrafin 41, të Raportit të KPT, të datës 03.03.2016, adresohet si një çështje me rëndësi të veçantë, ajo e pacientëve me çrregullime të rënda të shëndetit mendor, të deklaruar të papërgjegjshëm penalisht, të cilët vijnë në mbahen në sektorët e institucioneve penitenciare, në shkelje flagrante të legjislacionit kombëtar, pasi nuk është krijuar ende një institucion i specializuar psikiatrik. Sipas KPT-së, 2/3 e pacientëve me çrregullime të shëndetit mendore ndaj të cilëve ishte dhënë masë mjekësore, gjatë vizitës së misionit të KPT-së në vitin 2014, ishin akomoduar në IEVP Krujë. Sipas KPT-së, kushtet në të cilat këta persona qëndronin në këtë institucion ishin tepër problematike për shkak të braktisjes terapeutike, mungesës së mjekut psikiatër prej më shumë se një viti, reduktimit të stafit infermier, etj. KPT-ja kërkoi nga autoritetet shqiptare të shpejtojnë krijimin e një spitali psikiatrik.

³⁴Mbrojtja nga diskriminimi, tortura, trajtimet çnjerëzore dhe poshtëruese.

³⁵Deleguar për zbatim me Rekomandimin nr.87/3 të Këshillit të Ministrave të vendeve anëtare.

³⁶Të datës 20.03.2012.

KPT-ja në Raportin e vitit 2018 për Shqipërinë, ka evidentuar dhe theksuar qartësisht se: “...nëse autoritetet shqiptare vazhdojnë të mos zbatojnë rekomandimin e mëparshëm të parashikuar në paragrafin 32, që të gjithë pacientët psikiatrikë të transferohen në një institucion të posaçëm psikiatrik mjeko-ligjor, nuk do të ketë asnjë zgjidhje tjetër veçse të vendosë procedurën e parashikuar në nenin 10, paragrafi 2 i Konventës”.

Raporti citon ndër të tjera se: “KPT shpreh shqetësimin e saj serioz se, pavarësisht rekomandimeve specifike të përsëritura të bëra që prej vitit 2000, pacientët që duhet të trajtohen në spitale psikiatrike vazhdojnë të mbahen në IEVP Krujë dhe IVSHB Tiranë, kushte në të cilat, në vështrimin e KPT mund të konsiderohen lehtësisht si johumane dhe degraduese. Në fakt, kushtet e jetesës në të dy institucionet sipërcituar janë përkeqësuar nga vizita e vitit 2014. Gjithashtu, niveli i kujdesit psikiatrik ishte qartësisht i pamjaftueshëm. KPT i kërkon autoritetve shqiptare të përgatisin pa vonesë një plan të detajuar për ngritjen e një spitali psikiatrik si dhe të marrin masat e nevojshme për të nxitur ngritjen e tij të shpejtë. Në të dy këto institucione trajtimi psikiatrik i ofruar vazhdon të mbetet thuajse ekskluzivisht në farmakoterapinë, në mungesë të plotë të aktiviteteve terapeutike”.

KPT-ja në Raportin e datës 24.11.2023, citon ndër të tjera se: “...108. Tashmë në këtë pikë, KPT dëshiron të shprehë rezerva në lidhje me vendndodhjen e Institucionit Mjekësor të Posaçëm brenda kufijve të Burgut të Lezhës. Komiteti konsideron se prania e hekurave dhe rojeve të armatosura krijon një atmosferë shtypëse, jo të favorshme për ngritjen e një mjedisi terapeutik, ose për mbizotërimin e një karakteri mjekësor dhe jo penal”.

Në të njëjtën linjë me rekomandimet e KPT-së kanë qenë dhe rekomandimet e vazhdueshme të Avokatit të Popullit, ku është raportuar si problem i ngutshëm se marrëveshja ndërmjet MD dhe MSHMS, e parashikuar në ligjin nr.44/2012 “Për shëndetin mendor”, me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave me masë mjekësore “mjekim i detyruar në një institucion psikiatrik”, nuk ka gjetur zbatim akoma.

Pikat 1 dhe 2 të nenit 28, të ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, përcaktojnë se **masa mjekësore duke patur si qëllim kryesor mjekimin e personit, duhet të ekzekutohet pranë institucioneve mjekësore të posaçme, pjesë e sistemit shëndetësor të integruar të Ministrisë së Shëndetësisë.** Në këtë ligj janë disa dispozita që kanë të bëjnë direkt ose indirekt me kufizimin e lirisë së personave me aftësi të kufizuara:

Së pari, nenet 20-27 të ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, trajtojnë rastin e shtrimit të pavullnetshëm të personave me çrregullime të shëndetit mendor në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër. Ligji, duket se plotëson një nga kërkesat e KPDAK, pasi për shtrimin e personit, përveç ekzistencës së çrregullimit të rëndë mendor që kufizon aftësinë e personit për të kuptuar ose kontrolluar sjelljen e tij, kërkon të plotësohen në një njëjtën kohë edhe kushte të tjera, si rreziku i jetës së shëndetit të vetes ose të të tjerëve si dhe shterimi i mundësive të tjera alternative (neni 20, paragrafi 2).

Neni 45 i ligjit nr. 8331/1998 *“Për ekzekutimin e vendimeve penale”*, parashikon se, masa mjekësore me mjekim të detyruar ekzekutohet në institucionin mjekësor të specializuar, sipas përcaktimit që bën Ministria e Shëndetësisë mbi kërkesën e prokurorit. Pra, **ligji ka sanksionuar qartazi që këta shtetas duhet të trajtohen në institucione mjekësore të posaçme ku diagnostifikohen, kurohen dhe rehabilitohen me qëllim mbrojtjen e shëndetit mendor. Ata duhet të trajtohen dhe kurohen në mënyrë të barabartë me pacientët e tjerë, me çrregullime të shëndetit mendor. Ata gëzojnë të njëjtat të drejta dhe duhet të trajtohen në mënyrë të njëjtë me personat e tjerë që nuk kanë kryer vepër penale por që janë të papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tyre mendore.**

Mbajtja në Institucionin e Posaçëm Mjekësor Lezhë e shtetasit K. A. jo vetëm nuk i garanton atij trajtim kurues, siç ka urdhëruar gjykata, por përkundrazi, regjimi i zolues i i këtij institucioni mund të sjellë përkeqësimin më tej të gjendjes së tij mendore, pasi prania e hekurave dhe rojeve të armatosura, apo vendosja e këtij institucioni brenda një rrethimi penitenciar, krijon një atmosferë shtypëse, jo të favorshme për ngritjen e një mjedisi terapeutik, ose për mbizotërimin e një karakteri mjekësor dhe jo penal. Në mungesë të trajtimit të posaçëm dhe rehabilitues, mundësia që ky shtetas të ketë përmirësim shëndetësor është më e pakët dhe kjo vërtetohet edhe nga vendimi i mëvonshëm gjyqësorë për rishikimin e masës.

Ndër dispozitat kryesore të legjislacionit penal kombëtar që kanë të bëjnë me kufizimin e lirisë së personave me aftësi të kufizuara kur akuzohen, ndiqen penalisht ose dënohen për kryerjen e një veprë penale citojmë:

- Nenin 46 të Kodit Penal – *“Masat mjekësore dhe edukuese”*

“Masat mjekësore mund të jepen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepër penale... Masat mjekësore janë: 1. Mjekimi i detyruar ambulator; 2. Mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor.”

- Nenin 46 të Kodit të Procedurës Penale – *“Masat mjekësore të detyrueshme”*

“Në çdo rast, kur gjendja mendore e të pandehurit tregon se ai duhet të kurohet, gjykata, vendos, edhe kryesisht shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik. 2. Kur është vendosur ose duhet vendosur masa mjekësore e detyrueshme për të pandehurin, gjykata urdhëron që i pandehuri të ruhet në një institucion psikiatrik. 3. Gjatë hetimeve paraprake, prokurori i kërkon gjykatës të vendosë për shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik dhe kur vonesa paraqet rrezik, urdhëron shtrimin e përkohshëm deri në marrjen e vendimit nga gjykata.”

- Nenin 239 të Kodit të Procedurës Penale – *“Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik”*

“Kur personi që duhet arrestuar është i sëmurë mendërisht dhe për këtë shkak përjashtohet ose pakësohet shumë zotësia e të kuptuarit ose e vullnetit, gjykata në vend të paraburgimit mund të urdhërojë shtrimin e përkohshëm në një institucion psikiatrik, duke caktuar masat e nevojshme

për të parandaluar rrezikun e ikjes. 2. Shtrimi nuk mund të vazhdojë kur rezulton se i pandehuri nuk është më i sëmurë mendërisht.”.

- Nenin 45 të Ligjit Nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”:
“Ekzekutimi i zbatimit të masës mjekësore”, Kreu VI- Shëndeti mendor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe institucionet e posaçme e mjekësore i Ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”.

Këto dispozita kanë të bëjë me masat që merren për personin me aftësi të kufizuara mendore që ka kryer një vepër penale dhe kur shkalla dëmtimeve mendore është e atij niveli që e çliron nga përgjegjësia penale, ose kur personi është në ndjekje penale dhe gjendja e shëndetit të tij mendor e bën të pamundur pjesëmarrjen në proces.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se institucionet kundër së cilave u adresua çështja (DPB, MD, MSHMS dhe IEVP Lezhë) ishin në dijeni të problematikës së shtetasit K. A. dhe personave që ndodhen në të njëjtat kushte me të, dhe se kishin dështuar deri më tani të ndërmerrnin masat e duhura konkrete për zgjidhjen përfundimtare të situatës, gjë e cila pranohet edhe prej tyre.

Pavarësisht argumentit të sjellë nga palët e përfshira: DPB, MD, MSHMS se nga ana e tyre po punohet për hartimin e planeve afatshkurtëra dhe afatgjata për zgjidhjen përfundimtare të kësaj problematike dhe ndërtimit të një institucioni të veçantë mjekësor, gjë e cila sigurisht vlerësohet si një masë pozitive nga ana e Komisionerit; situata “de facto” e shtetasit K. A. nga viti 2021 e deri aktualisht mbetet e njëjtë. Pra, ai vijon të mbahet dhe trajtohet në ambjentet e IMP Lezhë, në kushte thuasje të ngjashme apo të njëjta me një institucion penitenciar, pavarësisht përmirësimeve të shtimit të stafit mjekësor apo dhe kushteve të tjera. Si ankuesi, rezultoi se ndodheshin edhe 445 shtetas të tjerë të akomoduar po aty. Për këta shtetas gjykata ka vendosur masën mjekësore “mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”.

Në kontekst të sa më sipër, ekzekutimi nga ana e prokurorisë i masave mjekësore “Mjekim i detyruar” dhe “Shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik” bie ndesh me parashikimet e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar (për sa kohë nuk kemi të bëjmë me një vendim gjyqësor që t’i deklarojë këta shtetas fajtorë për kryerjen e ndonjë vepre penale apo të ketë caktuar kufizimin e përkohshëm të lirisë së tyre). Shtetasit, ndaj të cilëve është dhënë masa mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”, vijnë të mbahen në ambjentet e IMP Lezhë, duke iu mohuar shërbimin mjekësor në përputhje me protokollin e miratuar të çrregullimeve të shëndetit mendor.

Njëkohësisht ndesh me legjislacionin shqiptar dhe ndërkombëtar bie dhe Ministria e Drejtësisë e cila mban në institucionet në varësi të saj, në mënyrë të paligjshme shtetas me kufizime të aftësisë mendore.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjitha institucionet.

Kjo është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së³⁷. Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, është një ligj kuadër që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Gjithashtu në ky Ligj, ka parashikuar në nenin 7/1: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”*.

Pra, siç rezulton qartazi, subjekti ankues (dhe të gjithë shtetasit/pacientët e tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme me të) është diskriminuar në raport me personat e tjerë me çrregullime të shëndetit mendor që kurohen dhe trajtohen në spitalet psikiatrike të sektorit publik. Ankuesit dhe pacientëve të tjerë të akomoduar në sistemin e IMP Lezhë, pavarësisht përmirësimit të kushteve dhe kthimit të tij në një institucion mjekësor të posaçëm, nuk u ofrohet i njëjti shërbim mjekësor si atyre në spitalet psikiatrike, për më tepër duke u kufizuar lirinë dhe të drejtat e sanksionuara në Kushtetutë, tej masës që përkon me vendim gjyqësor të formës së prerë. Legjislacioni nuk i konsideron këta shtetas si persona me çrregullime të shëndetit mendor të përjetshëm dhe pikërisht, ekzekutimi i masës mjekësore “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm” “de jure” dhe “de facto” bie ndesh me parashikimet ligjore të legjislacionit të brendshëm dhe standardet e vendosura në legjislacionin ndërkombëtar, për sa kohë nuk kemi të bëjmë me një vendim gjyqësor të formës së prerë që t’i deklarojë këta shtetas fajtorë për kryerjen e ndonjë vepre penale apo që të ketë caktuar kufizimin e përkohshëm të lirisë së tyre në ambientet e sistemit penitenciar.

Bazuar në faktet dhe situatën e analizuar më sipër Komisioneri konstaton se, situata e paraqitur është pasojë jo vetëm e përkatësisë në një grup të veçantë dhe aftësisë së kufizuar, por është rrjedhojë e ndërveprimit të këtyre dy shkaqeve me njëri-tjetrin, në të njëjtën kohë, në mënyrë të pandashme nga njëri- tjetri, duke sjellë pasoja veçanërisht të rënda për shëndetin dhe cilësinë e jetesës së këtyre pacientëve në përgjithësi dhe ankuesit konkretisht.

³⁷Referuar nenit 3, pika 8 ,e ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

“Diskriminim ndërsektorial” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit.”³⁸

Gjithashtu, bazuar në nenin 3/1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Çdo sjellje diskriminuese që është motivuar nga më shumë se një shkak, kur është kryer më shumë se një herë, kur ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, ose kur ka sjellë pasoja veçanërisht të dëmshme për viktimën përbën formë të rëndë të diskriminimit”, konsiderohet si formë e rëndë diskriminimi. Kjo dispozitë, nuk kërkon që të plotësohen në mënyrë kumulative të gjithë elementët, në lidhje me shkakun, recidivizmin, kohëzgjatjen dhe pasojat e sjelljes diskriminuese. Forma e rëndë e diskriminimit konstatohet me përmbushjen qoftë edhe të vetëm njërit prej elementëve të përcaktuar në këtë dispozitë ligjore.

Komisioneri, vlerëson se shkak i përkatësisë në një grup të veçantë dhe aftësisë së kufizuar, veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, në të njëjtën kohë, në mënyrë të pandashme me njëri-tjetrin, duke e ekspozuar subjektin ankues ndaj trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë. Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm, Komisioneri arrin në përfundimin se, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Drejtësisë, me veprimet dhe mosveprimet e tyre, kanë diskriminuar për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë dhe aftësisë së kufizuar, subjektin ankues të gjithë shtetasit/pacientët e tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, lidhur me mosmarrjen e masave për ofrimin e njëjtë të shërbimit mjekësor si atyre në spitalet psikiatrike, për më tepër duke u kufizuar lirinë dhe të drejtat e sanksionuara në Kushtetutë, tej masës që përkon me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Barazia dhe mosdiskriminimi imponojnë jo vetëm ndalimin e diferencës në trajtim, por edhe detyrimin për të adresuar ndryshe nevojat e veçanta që kanë grupe të ndryshme të cilët janë më shumë të cenueshëm ose vulnerabël. Dështimi për të përmbushur detyrimet e mësipërme, përbën diskriminim.

Komisioneri, thekson faktin se, pavarësisht se nuk ka qenë qëllimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Drejtësisë, që të vendosin në pozita të pafavorshme dhe të pabarabarta subjektin ankues të gjithë shtetasit/pacientët e tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, mungesa e tij, nuk i përjashton nga përgjegjësia, në kushtet kur provohet se këto institucione përgjegjëse, nuk ka arritur që të shmangin pasojat, duke bërë që shtetasve ndaj të cilëve është dhënë masa mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”, duke iu mohuar shërbimin mjekësor në përputhje me protokollin e miratuar të çrregullimeve të shëndetit mendor dhe duke mos gëzuar në baza të barabarta, të drejtën për kurimin dhe trajtimin e tyre njëjloj si personat e vendosur në spitalet psikiatrike të sektorit publik.

³⁸ Neni 3, pika 3, e LMD-së.

Në këto kushte, Institucioni Mjekësor i Posaçëm Lezhë është pjesë e sistemit penitenciar ku zbatohen rregulloret përkatëse për trajtimin e personave të burgosur. Ndërkohë që subjekti ankues dhe të gjithë shtetasit e tjerë, me çrregullime të shëndetit mendorë në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, janë pacientë të shëndetit mendor dhe jo shtetas të dënuar.

PËR KËTO ARSYE :

Në bazë të nenit 32 dhe 33, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, *në fomën e rëndë të tij dhe në formën e diskriminimit ndërsektorial*, për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë” dhe të “aftësisë së kufizuar” të shtetasit K. A. dhe të gjithë kategorisë të personave me çrregullime të shëndetit mendor të ndodhur në të njëjtat apo kushte të ngjashme me të, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Në referim të pikës 1, MSHMS me bashkëpunimin e MD, deri në ngritjen e një institucioni të posaçëm përfundimtar:
 - Të marri të gjitha masat e nevojshme për përshtatjen e ambienteve të Institucionit Mjekësor të Posaçëm Lezhë³⁹, sipas legjislacionit të cituar më sipër në këtë vendim, për akomodimin e shtetasve me vendim gjykate me masë mjekësore “Shtrim i detyruar në një institucion psikiatrik”, si një institucion i posaçëm mjekësor.
 - Ta pajisë atë me të gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe të domosdoshme mjekësore dhe plotësimin e personelit të specializuar mjekësor dhe psiko-social.
3. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, MSHMS, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Rekomandohet sërish Prokuroria e Përgjithshme të udhëzojë në mënyrë të qartë të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda, si dhe pranë gjykatave të Apelit, për zbatimin në mënyrë korrekte të ligjit “*Për ekzekutimin e vendimeve penale në RSH*”, konkretisht, për zbatimin në mënyrë të ligjshme të vendimeve të gjykatës lidhur me masën mjekësore “*Mjekim i detyruar në një institucion psikiatrik*”.

³⁹Referuar paragrafit III, faqe 6 e vendimit.

6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë dhe aftësia e kufizuar)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)

(Forma: E rëndë dhe ndërsektorial)